

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Winter 2-2018

AUDITIMI I JASHTËM DHE NDIKIMI I TIJ NË BIZNESE

Rozana Morina

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)



Kolegji UBT
Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

AUDITIMI I JASHTËM DHE NDIKIMI I TIJ NË BIZNESE
Shkalla Bachelor

Rozana Morina

Shkurt / 2018
Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome
Viti akademik 2015-2016

Rozana Morina

AUDITIMI I JASHTËM DHE NDIKIMI I TIJ NË BIZNESE

Shkalla Bachelor

Mentor: Prof.Bukurije Jusufi

Shkurt / 2018

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Auditimi i jashtëm është një ekzaminim i pavarur i pasqyrave financiare të përgatitura nga organizata e cila e bën auditimin. E kjo zakonisht bëhet për qëllime staturore (pasiqë ligji e kërkon kryerjen e një procesi të tillë). Një rezultat auditimi paraqet një opinion në lidhje me pasqyrat financiare, pra a paraqesin pasqyrat financiare një pamje të vërtetë e të drejtë apo jo. Auditorët emërohen nga kompania e auditimit e cila bën auditim të jashtëm, ata janë të pavarur nga organizata në të cilën janë të angazhuar për kryerjen e auditimit. Pra të jesh i pavarur do të thotë se auditori nuk duhet të ketë qenë i përfshirë në mbajtjen e shënimeve të kontabilitetit dhe nuk është i lidhur personalisht në asnjë mënyrë me organizatën që auditohet.

Qëllimi i auditimit të jashtëm është për të verifikuar se llogaritë vjetore (pasqyrat financiare) japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë të organizatës që auditohet. Pra, roli kryesor i auditimit nuk është vetëm zbulimi i mashtrimit, edhe pse kjo sigurisht do të dalë në pah përgjatë kontrolleve që ndodhin si procedurë e auditimit nëse egziston. Opinioni i auditorit i cili lëshohet në fund shërben për pronarët e kompanisë që auditohet dhe është shumë i nevojshëm për ta për shkak të besueshmërisë së pasqyrave financiare, ku mund të merren më lehtë kreditë nga bankat e ndryshme, ngrihen me lehtë investitorët e jashtëm kur ata kanë një raport të auditorit, i ndihmon furnitorët e asaj kompanie dhe të gjithë ata të cilët dëshirojnë të kenë apo kanë marrëdhënie me kompaninë në fjalë.

Auditorët kanë një kohë të kufizuar në të cilën ata kryesisht koncentrohen në kryerjen e një testimi të vlefshëm për ato mostra të përzgjedhura nga transaksione të caktuara, kontrollimin e plotë dhe me shumë kujdes të dokumenteve mbështetëse për to si dhe paraqitjen e rezultateve reale të testeve të kryera. Edhe pse pavarësia e auditorit duhet patjetër të respektohet dhe vëzhgohet përgjatë tërë kohës, ne duhet të kemi parasysh që duke ofruar këtë shërbim ata e bëjnë në këmbim të një tarife të caktuar që paguhet nga kompania e cila auditohet. Puna e auditimit duhet të shikohet si një eksperiencë pozitive dhe jo si një profesion që duhet të kemi frikë nga kontrollet përgjate punës së auditimit, pra auditimi është një mundësi për të marrë informacione për pikat e forta dhe ato të dobëta brenda përbrenda kompanisë.

MIRËNJOHJE DHE FALENDËRIME

Unë do të doja të fillojë tezën time me falendërimin për të gjithë ata që më ndihmuan dhe më dhanë kurajë të realizojë Punimin e Diplomës së Bachelor-it në drejtimin Kontabilitet, Auditim dhe Tatime.

Jam mirënjohëse dhe sinqerisht e falendëroj mentorin e temës Prof. Bukurie Jusufi pa të cilën ky studim nuk do të ishte i mundur.

Do të doja të shpreh falendërimet më të sinqerta për mbështetjen dhe përkrahjen familjen dhe shoqërinë time.

Rozana Morina
Dhjetor 2017
Prishtinë

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE.....	V
1. HYRJE.....	1
2 SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	2
2.1 Auditimi, ekipi i auditimit, objektivat dhe fazat e procesit të auditimit	2
2.1.1 Cilësia e komunikimit.....	3
2.1.2 Takimet e ekipit të auditimit.....	3
2.2 Fazat e procesit tëauditimit të jashtëm.....	5
2.2.1 Pranimi dhe vazhdimi i punës me klientit	5
2.2.2 Themelimi i kushteve të angazhimit.....	5
2.2.3 Paraplanifikimi	6
2.2.4 Themelimi i materialitetit dhe vlerësimi i rrezikut.....	6
2.2.5 Planifikimi i auditimit.....	8
2.2.6 Mbajtja parasysh e kontrolleve të brendshme	10
2.2.7 Auditimi i proceseve të biznesit dhe llogarive përkatëse	10
2.2.8 Kryerja e auditimit. dhënia e opinionit të auditimit.....	11
2.2.9 Atributet e një gjetje te auditimit.....	12
2.3 Mostrat	13
2.3.1 Krahasimi i mostrave statistikore dhe jo-statistikore	15
2.3.2 Metodatat ose teknikat e ndryshme të zgjedhjes së mostrave	16
2.4. Performmi i testeve të auditimit.....	17
2.4.1 Testet e Kontrollit (TOC)	17
2.4.2 Procedurat substanciale	17
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT	30
4. METODOLOGJIA	31
5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE.....	32

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	36
7. REFERENCAT	40

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Auditori Kryesor dhe ekipi i tij	4
Figura 2. Pesë atributet e një gjetje te auditimit	12
Figura 3. Program kompjuterik për zgjedhjen e mostrës.....	14
Figura 4. Numërimi i Stokut.....	22
Figura 5. Model i regjistrit të mjeteve themelore	25
Figura 6. Model i një konfirmimi bankar	29

1. HYRJE

Ky punim shfaq çeshtjet thelbësore të kryerjes së procesit të auditimit të jashtëm për pasqyrat financiare të entitetit i cili auditohet. Trajton çeshtjet dhe problematikat që mund të shkakton mungesa e auditimit të jashtëm, rëndësinë e auditimit të jashtëm si dhe vështirësitë e të bërit auditim në kompani të ndryshme.

Në këtë punim janë shtjelluar keto çeshtje: ekipi i auditimit, objektivat, atributet si dhe fazat e procesit të auditimit. Rëndësia e gjithësecilës paraqet në tërësi rëndësinë e auditimit të jashtëm. Pra, trajtohet çeshtja e të bërit auditim, sa është e rëndësishme që ekipi i cili kryen punën e auditimit të jetë profesional dhe i kualifikuar. Poshtu njëçeshtje shumë e rëndësishme në punën e auditimit është edhe komunikimi si dhe bashkëpunimi në mes të ekipit punues.

Punimi merret si me gjërat dhe termet bazike sa i përket fushës së auditimit të jashtëm, pra qysh nga faza e inicimit të punës së auditimit, mbajtja e mbledhjeve për fillimin e punës, përcaktimi i ekipit, përzgjedhja e testimeve, përcatimi i materialitetit, selektimi i mostrave nga transaksionet të cilat testohen, mbedhja e të dhënave, kontrollimi i dokumenteve mbështetëse, paraqitja e rezultateve, definimi i të gjeturave, diskutimi i perfundimit të punëve dhe rezultateve të gjetura me grupin e auditimit, formimi “Letër menaxhmentit” me definimin e pikave kryesore pra, të gjeturat dhe rekomandimet, diskutimi i tyre me menaxhmentin e kompanisë e deri tek dhënia e opinionit përfundimtar për pasqyrat financiare të auditura të kompanisë.

Qëllimi i këtij punimi është që të bëhet përshkrimi i të gjitha fazave të auditimit, si dhe definimi i rëndësisë që ka auditimi i jashtëm në mbarëvajtjen e të gjitha organizatave pa marrë parasysh llojin e organizatës, respektimin e ligjeve, rregulloreve e poashtu edhe të standardeve ndërkombëtare për përpilim të pasqyrave financiare si dhe standardeve ndërkombëtare për raportim financiar.

2 SHQYRTIMI I LITERATURËS

Ky kapitull është ndarë në disa pjesë që ndihmojnë për të krijuar kuadrin teorik të të gjithë punimit në mënyrë të qartë dhe logjike, ku është shqyrtuar literatura që përfshinë fazat e procesit të auditimit, objektivat, ekipin auditues, mostrat, performimi i testeve etj.

2.1 Auditimi, ekipi i auditimit, objektivat dhe fazat e procesit të auditimit

“Sipas mendimit tonë një auditim efektiv me të vërtetë sfidon dhe teston përmbajtjen e pasqyrave financiare në mënyrë që të jap opinion nëse këto pasqyra paraqesin gjendjen reale të kompanisë” (*Assessing the effectiveness of the external audit process*). Auditimet janë më të efektshme kur kryhen nga profesionistë të kualifikuar të cilët punojnë së bashku dhe janë të fokusuar në objektiva të qarta. Natyra e projekteve të auditimeve, karakteristikat profesionale të stafit dhe teknologjia e përparuar në dispozicion për auditorët bën të mundur që ekipet e auditimit të funksionojë në mënyrë efektive.

Çdo auditim mund të shihet si një projekt, një aktivitet me një fillim dhe fund. Një ekip formohet për të kryer projektin. Kushdo që do të marr pjesë në këtë projekt është pjesë e ekipit të auditimit. Kjo përfshin stafin e auditorëve, stafin mbështetës, auditorë të lartë (senior auditor), mbikëqyrësit (supervisor) dhe menaxherët e auditimit.

Anëtarët e ekipit janë vlerësuar për njohuritë e tyre. Ata e dinë se si kryet auditimi dhe ata e kuptojnë mjedisin ku punojnë. Megjithatë, ekzistojnë dallime në mes anëtarëve të ekipit që janë të rëndësishme për të kuptuar nëse ekipi është në gjendje që të funksionojë në mënyrë produktive. Disa anëtarë mund të kenë më shumë përvojë, disa të tjerë mund të jenë më të aftë në komunikim, dhe të tjerët mund të jenë më të fortë në aftësitë organizative. Anëtarët e ekipit duhet të njohin këto dallime dhe talentet që secili anëtar sjell në ekip.

2.1.1 Cilësia e komunikimit

Çelësi për punën në grup efektiv është komunikimi. Asgjë tjetër nuk është më e rëndësishme. Çdo individ në ekip duhet të dijë se çfarë po ndodh dhe ka nevojë për të marrë pjesë në një diskutim kur merren vendimet. Kjo është mënyra më e mire në të cilën ekipi mund të arrijë mirëkuptim mes individëve, pra, planifikojnë qasjen më të mirë të auditimit të me mirëkuptim.

Anëtarët e ekipit duhet të bashkëveprojnë për ekipin që puna të jetë efektive. Duhet ta ndihmojnë njëri tjetrin për arsye se në auditim gjithmonë dalin gjëra të reja. Bashkëveprimi në ekip në disa raste ndodh në mënyrë spontane dhe më zyrtarisht në raste të tjera. Bashkëveprimi duhet të jetë në kohë. Anëtarët individual të ekipit nuk duhet të mbajnë informacione, ide apo mendime individuale dhe të mos i tregojnë ekipit. Pjesëmarrja e plotë nga të gjithë anëtarët e ekipit është një faktor i rëndësishëm në suksesin e auditimit. Megjithatë, paaftësia një anëtari të ekipit për të participuar me ekipin, gjatë çdo pjese të auditimit, nuk duhet të ngadalësojë punën e ekipit.

2.1.2 Takimet e ekipit të auditimit

Gjatë çdo faze të një auditimi, mbledhjet e anëtarëve të ekipit janë mëse të nevojshme. Skemat e procesit të auditimit identifikojnë disa pika ku takimet e ekipit mund të ndodhin. Takimet duhet të jenë të planifikuara në pikat kryesore vendimmarrëse në këtë proces. Takimet duhet të ndodhin edhe në mes të auditorëve, edhe pse ata janë bashkë ditë-për-ditë në punë. Auditorët duhet të ndajnë gjetjet (findings) dhe vërejtjet e tyre lidhur me mjedisin e auditimit. Takimet me mbikëqyrësit dhe menaxherët duhet të ndodhin kur çdo anëtar i një ekipi beson se një takim i tillë është i nevojshëm. Niveli i pjesëmarrjes së stafit në takimet e ekipit varen nga objektivat e takimit.

Qëllimet e mbledhjeve janë për të shkëmbyer informacion dhe për të përmirësuar cilësinë e auditimit. Çdo anëtar i ekipit duhet të jenë i informuar mirë në lidhje me punën dhe rezultatet e auditimit. (*Principles of External Auditing*, 2003)

Anëtarët e ekipit duhet të rishikojnë (të bëjnë review) punën e njëri-tjetrit në mënyrë që të sigurojnë cilësinë e punës së njëri-tjetrit.



Figura 1. Auditori Kryesor dhe ekipi i tij

2.2 Fazat e procesit tëauditimit të jashtëm

2.2.1 Pranimi dhe vazhdimi i punës me klientit

Sipas Standardeve Ndërkombtare të Auditimit SNA auditorët duhet të krijojnë politika dhe procedura për të vendosur nëse do të pranojnë të punojnë më një klient të ri apo të mos e pranojë klientin e ri dhe të vazhdojnë të punojnë më klientët e deritanishëm. Auditori duhet të kuptojë entitetin dhe mjedisin ku vepron, pra, të ketë informata për natyrën e entitetit, faktorët industrial, menaxhmentin, qeverisjen, objektivat, strategjitë, performancën dhe proceset e biznesit ku bëhet auditimi.

2.2.2 Themelimi i kushteve të angazhimit

Themelimi i kushteve të angazhimitka të bëjë me kushtet me të cilat auditori pajtohet me klientin e tij për sa i takon shërbimeve qe kryhen dhe të gjitha kushtet shkruhen ne letër angazhim. Letër angazhimi shënohet me disa detaje ku shënohet se ekipi i auditimit është komplet i pavarur dhe nuk ka asnjë lidhje me palët që auditohen si nga kompania ashtu edhe nga individet e ekipit të auditimit. Poashtu shënohen emri, mbiemri dhe nënshkrimi i të gjithë personave që janë në ekip të auditimit në kompaninë e cila do të auditohet apo në kompaninë me të cilën shkruhet letër angazhimi kjo për arsye të konfidencialitetit të të dhënave pasi që auditori ka qasje në pothuajse të gjitha të dhënat e kompanisë që shumë pak persona të kompanisë që auditohet i zotrojnë.

Letër angazhimi duhet të përmbajë:

- pranimin e angazhimit nga ana e auditorit
- synimin dhe fushëveprimin e auditorit
- shtrirjen e përgjegjësisë së auditorit
- formën e raporteve që duhet të përgatiten.

2.2.3 Paraplanifikimi

Paraplanifikimii auditimitka të bëjë me dy aktivitete kryesore: përcaktimi i personave të nevojshëm (anëtarët e ekipit) të cilët e kryejnë auditimin dhe pavarësinë e personave të cilët e bëjnë auditimit. P.sh. nëse një anëtar i auditimit ka ndonje familjarë të afërt apo të largët apo ka ndonjë lidhje me ndonjë të punësuar në kompaninë e cila auditohet atëherë ai anëtar i ekipit të auditimit duhet të zëvendësohet me një person tjetër në mënyrë që të ruhet pavarësia dhe integriteti i auditimit.

2.2.4 Themelimi i materialitetit dhe vlerësimi i rrezikut

Themelimi i materialitetit dhe vlerësimi i rrezikut ka të bëjë me të gjykuarit e materialitetit dhe të vlersuarit e rrezikut në mënyrë që të përdoren për të përcaktuar objektin e auditimit. Materialiteti përdoret për të vlerësuar në qoftëse te gjeturat përgjatë punës së auditimit janë gjetje për tu diskutuar, pra në çoftëse këto të gjetura janë materiale apo jo. Që të dy anët edhe anët kaulitative edhe ato sasiore janë të rëndësishme në gjetjen e materialitetit. Materialitetit kuantitativ kalkulohet si një perqindje e numrave domethënës në pasqyrat financiare pra të **të hyrave** apo **shumës totale të aseteve**. Pastaj auditorët e përdorin këtë numër të përcaktuar si materialitet në disajnimin e testimeve të tyre. Pastaj një franksion i materialitetit është i quajtur si **“Gabimi i Tolerueshem”** dhe paraqet gabimin maksimal të tolerueshëm e që auditorët pas gjetjeve të tyre do të toleronin në mostrat e perzgjedhura dhe të testuara. Prania e konsideratave cilesore te riskut mund t'i shkaktoje nje auditori obligim për të rregulluar fushat e testimit. Ato poashtu mund te kenë ndikim në dhënien e opinionit te auditorit ne lidhje me nivelin e gabimit që mund të tolerohet dhe thjeshte ne masa sasiore te konsiderohet edhe si jomaterial.

Planifikimi i materialitetit bëhet në tre hapa:

1. Themelimi i një gjykimi paraprak të materialitetit
2. Përpjestimi i gjykimit paraprak nëpër saldot e llogarive individuale, grupeve të llogarive apo transaksioneve të ndryshme
3. Vlersimi i rreziqeve-anomalive materiale dhe krahasimi i tyre me materialitetin e gjetur me pare apo gabimin e tolerueshëm

Faktoret cilesore qe mund te kene influencë në përcaktimin e materialitetit:

- a) Konsideratat cilësore
- b) Efekti i mundshëm i gabimeve mbi trendet e sidmos tendenca për fitim.
- c) Një anomali që ndryshon një humbje në të ardhura apo anasjelltas
- d) Efekti i mundshëm i mospërputhjeve në nderlidhjen e kompanisë me faktorët përfshirës tek kreditë
- e) Ekzistenca e kërkesave statusore ose rregulloreve të raportimit që ndikojnë në pragjet e materialitetit
- f) Një ndryshim në fitimet e maskuara ose në trendet tjera, e veçanërishtë në kontekstin e përgjithshëm ekonomik.
- g) Kushtet e industrisë
- h) Një mospërputhje që ka ndikim në rritjen e kompensimeve për menaxhmentin, për shembull plotësimi i kerkesave për dhënien e bonuseve apo formave të tjera të kompensimit stimulues
- i) Ndjeshmëria e rrethanave që mund të çojnë ne keqinterpretim të mosperputhjeve, per shembull implikimet e anomalive që perfshijnë mashtrimet dhe akte tjera të

paligjshme, shkelja e dispozitave kontraktuese si kushtet e kredive, si dhe konflikti i interesave,

- j) Niveli i ndikimit të pasqyrave financiare nga mospërputhjet
- k) Efekti i mungesës së klasifikimeve për shembull mosklasifikimi i të hyrave operative si dhe i atyre jooperative, apo i të hyrave periodike dhe atyre joperiodike.

2.2.5 Planifikimi i auditimit

Planifikimi i auditimit ka të bëjë me planifikimin të cilin e bën auditori e që paraqet në detaje natyrën, shtrirjen dhe kohëzgjatjen e auditimit. Në fazën e planifikimit kur auditorët janë duke i dizajnuar testet që do t'i përdorin përgjatë fazës së auditimit, pohimet e pasqyrave financiare ndihmojnë që auditorët të fokusohen në ato çështje që janë më të rëndësishme për pasqyrat financiare. (*Principles of External Auditing*, 2003)

Sipas ACCA F8- *Auditing And Accounting* ,auditorët në përgjithësi do të konsiderojnë pohimet të ndara në këto kategori:

a) **Transaksionet:**

- Ndodhia (occurrence)– Transaksionet kanë ndodhur,
- Plotësia- Transaksionet që duhet të ishin regjistruar kanë qënë regjistruar në mënyrë të përshtatshme,
- Saktësia- Shuma e transaksionit dhe të dhënat e tjera janë regjistruar në mënyrën e duhur,
- Prerja(Cut Off)- Transaksionet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël,

- Klasifikimi - Transaksionet janë regjistruar në kontot përkatëse.

b) Bilancet e llogarive

- Ekzistenca – Pasuritë, detyrimet dhe neto kapitali aksionar në të vërtetë ekzistojnë.
- Të drejtat dhe obligimet - Entiteti ka të drejta mbi pasuritë dhe është i detyruar për të përmbushur detyrimet,
- Plotësia - Të gjitha pasuritë, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhej të ishin regjistruar janë regjistruar,
- Vlerësimi dhe alokimi - Pasuritë, detyrimet dhe kapitali aksionar janë përfshirë si dhe rregullimet janë regjistruar në mënyren e duhur ne pasqyrat financiare

c) Prezantimi dhe shpalosjet

- Dukuritë, të drejtat dhe detyrimet - transaksionet zbulohet që kanë ndodhur dhe që i përkasin subjektit
- Plotësia - Dhënia e informacioneve shpejguese që duhej të ishin përfshirë kanë qënë përfshirë
- Klasifikimi dhe kuptueshmëria - Informacioni financiar është paraqitur dhe përshkruar në mënyrën e duhur si dhe shpalosjet janë bërë ne mënyre të qartë dhe të kuptueshme
- Saktësia dhe vlerësimi - Informacioni është shpalosur në mënyrë të drejtë dhe në vlerën reale.

2.2.6 Mbajtja parasysh e kontrolleve të brendshme

Në këtë fazë të procesit të auditimit kanë ndikim bordi i drejtorëve dhe ajo pjesë që kanë për detyrë të japin një siguri të arsyeshme për sa i takon arritjes së objektivave që janë: besueshmëria e pasqyrave financiare, efektiviteti dhe efienca operative dhe të vepruarit në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat janë momentalisht në fuqi. “Po ashtu auditorëve të jashtëm i’u ndihmon shumë edhe nëse ajo kompani e cila auditohet ka personel i cili bën auditim të brendshëm dhe jepet një pikëpamje mbi besueshmërinë e të dhënave financiare”. Ref.(*Principles of External Auditing, 2003*)

2.2.7 Auditimi i proceseve të biznesit dhe llogarive përkatëse

Auditimi i proceseve të biznesit dhe llogarive përkatëse është faza pothuajse kryesore sepse këtu është faza më e gjatë dhe me punën më të madhe sepse kjo fazë zhvillohet tek klienti ,pra, në teren ku ndihmohet procesi i auditimit nga personeli i kompanisë që auditohet me materiale dhe dokumente të ndryshme të kompanisë. Këtu kryhen procedura individuale llogaritë (zërat e ndryshëm) saldot e të cilave mund të kenë anomali materiale

Tek procedura e të transaksioneve të biznesit i cili auditohet me rëndesi është nga pesoni i cili po kryen auditimin të kuptohet mënyra se si po kryhet procesi I regjistrimit të secilit transaksion që nga fillimi deri në fund, si dhe nga kush po kryhet ky proces, a është duke u përformuar në mënyrën e duhur, si dhe nese ka pasur gabime a janë matriale apo nëse për momentin nuk janë, a ekziston mundësia që të behën mospërputhje materiale në të ardhmen.

Pra kjo procedurë fillon qysh nga kuptimi i pesonelit përfshirës përgjatë regjistrimeve të transaksioneve nga fillimi e deri në fund. Pas kuptimit se cilët janë personat përgjegjës, pastaj fillojnë takimet me ta dhe diskutimet për çështjet të cilat janë më rëndesi, gjithmonë duke u bazuar në transaksionin që jeni duke e përcjellur, në baze të natyrës së transaksionit bëhet edhe formulimi i pyetjeve që kërkojnë përgjigje. Pastaj është shumë me rëndesi programi në të cilin bëhet regjistrimi i transaksioneve përkatëse, dhe poshtu ka mundësi që shumë kompani e bëjnë regjistrimin vetëm në programe të thjeshta si Excel, dhe në qoftë së natyra e transaksioneve është më e ndërlikuar, atëherë edhe mundësia e gabimit dhe mos procesimit të të dhënave është më e madhe, pra kërkohet që të jenë programe më komplekse dhe më të avancuara.

Pastaj shikohen ligjet, procedurat si dhe standardet që duhet ndjekur, a janë ndjekur nga personeli përkatës.

2.2.8 Kryerja e auditimit. dhënia e opinionit të auditimit

Përfundimi ose kryerja e auditimit ka të bëjë me evidencat e mjaftueshme të marra nga klienti të cilat duhet t'i posedoj auditori në mënyrë që të arrij në një përfundim të saktësisë së pasqyrave financiare. Pas përfundimit të punës në teren shikohen gjetjet e bëra nga dokumentet e pranuar nga klienti.

“Dhënia e raportit të auditimit kjo fazë është faza finale e procesit të auditimit e cila ka të bëjë me dhënien e raportit të auditimit nga auditori pra, raportimin se a janë në rregull

pasqyrat financiare. Kjo pjesë spjegohet më detajisht në vazhdim të këtij punimi” (2003)
Principles of External Auditing.

Kemi këto lloje të opinionit të auditimit:

1. Opinion i pakualifikuar (pa rezervë)
2. Opinion i kualifikuar (me rezervë)
3. Refuzim i opinionit
4. Opinion i kundërt

2.2.9 Atributet e një gjetje të auditimit

E cekur në “*The Audit Progress*”, elementet e nevojshme për një konstatim të auditimit varen nga objektivat e auditimit, një gjetje mire e zhvilluar e auditimit në përgjithësi përmban pesë attribute




Figura 2. Pesë atributet e një gjetje të auditimit

Zhvillimi i attributeve udhëheq ekipin e auditimit në organizimin dhe analizimin e provave relevante dhe ndihmon për të siguruar që të gjitha informatat e nevojshme për konstatim janë identifikuar, zhvilluar dhe dokumentuar në mënyrë adekuate.

2.3 Mostrat

Përzgjedhja e mostrave të kontrollit, percjellja si dhe ripërformimi i tyre, për të marrë dëshmi se ata veprojnë në mënyrë efektive.

Pasiqë bëhet kuptimi i procedurës së regjistrimit të transaksioneve atëherë bëjmë zgjedhjen e disa mostrave për testim për të bindur veten që nëse realisht është ndjekur procedura e duhur. Zakonisht përzgjedhja e mostrave bëhet me programe përkatëse që janë të krijuara posaqërisht për selektimin e mostrave, si dhe kalukulime tjera të nevojshme gjatë punës së auditimit, zakonisht krijohet nga stafi i teknologjise informative brenda kompanisë së auditimit, disa nga programet për përzgjedhjen e mostrave janë: IDEA, GAMEX, Canvas Sampling Program etj.

Pasi që bëhet selektimi i mostrave, fillon të bëhet edhe testimi i tyre për të parë në qoftë se ato janë regjistruar në mënyrën e duhur, ashtu sipas procesit të cilin e kemi vërtetuar që në fillim.

Me rritjen e madhësisë së bizneseve, auditorët është dashur të mbështeten në procedurat e zgjedhjes së mostrës, si mënyrë e vetme dhe më praktike për sigurimin e evidencës së auditimit. Mbështetja në mostër është një nga arsyet bazike që raportet e auditimit trajtohen si shprehje e opinionit, e jo si certifikim absolut të paraqitjes së drejtë të pasqyrave financiare.

Te cekura në (2003) *Principles of External Auditing* kemi:

Mbështetja në mostër të auditimit, qoftë ajo statistikore apo jo-statistikore, është proces i zgjedhjes së një grupi të njësive (të quajtur mostër) nga një grup i madh i njësive (i quajtur **popullim apo masë**) dhe shfrytëzimi i karakteristikave të mostrës për të nxjerrë konkluzione lidhur me karakteristikat e tërë popullimit apo masës. Supozimi i bërë është që mostra do të lejojë auditorëve të ndërmarrin konkluzione të sakta lidhur me popullimin. Mbështetja në mostër shoqërohet me **rrezik të mostrimit**—rreziku që konkluzioni i arritur duke u bazuar në mostër mund të jetë i ndryshëm nga konkluzioni i cili mund të arrihej nëse auditorët do të ekzaminonin çdo njësi të popullimit.

Rreziku i mostrimit mund të *reduktohet* duke rritur madhësinë e mostrës. Vetëm nëse auditorët ekzaminojnë të gjitha njësitë e popullimit, atëherë mund të themi rreziku i mostrimit është i barabartë me zero.

Por, auditimi i mostrave të mëdha ose auditimi i të gjitha njësive të popullimit ka kosto shumë të lartë. Elementi kryesor në zgjedhjen efikase të mostrës është balancimi i rrezikut të mostrimit me koston e shfrytëzimit të mostrave më të mëdha. Auditorët mund të nxjerrin konkluzione të gabuara për shkak të gabimeve që *nuk kanë të bëjnë me mostrën*—gabime që janë si pasojë e faktorëve jo të shkaktuara direkt nga shfrytëzimi i mostrës.





Figura 3. Program kompjuterik për zgjedhjen e mostrës

2.3.1 Krahasimi i mostrave statistikore dhe jo-statistikore

- Mostra thuhet që është jo-statistikore (e bazuar në gjykim profesional) kur auditorët bëjnë vlerësimin e rrezikut të mostrimit duke u bazuar në gjykimin profesional në vend të teknikave statistikore. Kjo nuk do të thotë që mostrat jo-statistikore janë zgjedhje e mostrës në mënyrë të pakujdesshme. Në fakt, si mostrat statistikore ashtu dhe mostrat jo-statistikore duhet të zgjedhën në atë mënyrë që ti mundësoj auditorëve të nxjerrin konkluzione valide lidhur me popullimin. Pos kësaj, gabimet e gjetura në mostrat statistikore ose jo-statistikore duhet të shfrytëzohen për vlerësimin e shumës totale të gabimit në popullimin e caktuar (i quajtur **gabimi i projektuar**). Sidoqoftë, mostra jostatistikore nuk ofron ndonjë mundësi për kuantifikimin e rrezikut të mostrimit. Prandaj, auditorët mund të gjenden në pozitë ku mostra e zgjedhur ngërthen në vete kosto më të madhe, si dhe mund të jetë më e madhe sesa që është e nevojshme, ose pa dijeni të tyre auditorët mund të pranojnë nivel më të madh të rrezikut të mostrimit.
- “Shfrytëzimi i *mostrave statistikore* nuk nënkupton eliminim të gjykimit profesional gjatë procesit të zgjedhjes së mostrës.” (2003) *Principles of External Auditing*, Sidoqoftë, mostra statistikore i mundëson auditorëve të masin dhe të kontrollojnë rrezikun e përdorimit të mostrës. Përmes teknikave për *zgjedhje e mostrës statistikore*, auditorët mund ta specifikojnë qysh përpara rrezikun e mostrimit që ata dëshirojnë ta kenë në rezultatet e mostrës dhe pastaj ta llogarisin madhësinë e mostrës e cila e mbanë rrezikun e mostrimit në nivel të dëshiruar. Pasi që teknikat e zgjedhjes së mostrës statistikore bazohen në ligjet e probabilitetit, auditorët janë të aftë ta kontrollojnë nivelin e rrezikut të mostrimit gjatë mbështetjes në rezultatet e mostrës.

Prandaj, mostra statistikore mund ti ndihmojë auditorët në :

- dizajnimin e mostrave më efikase,

- vlerësimin e mjaftueshmërisë së evidencës së siguruar, dhe
- vlerësimin objektiv të rezultateve.

Sidoqoftë, këto përparësi nuk arrihen pa kosto shtesë për trajnimin e stafit të auditimit, dizajnimin e planeve të zgjedhjes së mostrës, dhe zgjedhjen e njësive për ekzaminim. Për këto arsye, mostrat jo-statistikore përdoren shumë shpesh nga auditorët, posaçërisht për testimin e popullimeve relativisht të vogla. Si mostrat statistikore ashtu edhe ato jo-statistikore auditorëve mund ti sigurojnë evidencë të mjaftueshme dhe të duhur të auditimit.

2.3.2 Metodatat ose teknikat e ndryshme të zgjedhjes së mostrave

- **Zgjedhja e rastësishme** e cila bën të sigurt se të gjithë elementët e një popullate kanë një shans të barabartë për t'u zgjedhur, p. sh. nëpërmjet përdorimit të tabelave me numra të rastësishëm ose zgjedhjes së mostrave me anë të programeve kompjuterike.
- **Zgjedhja sistematike** ka të bëjë me zgjedhjen e elementëve duke përdorur një interval konstant midis zgjedhjeve, ku intervali i parë zgjidhet në mënyrë të rastësishme. Në rastet kur përdoret zgjedhja sistematike auditorët duhet të bëjnë të sigurt se popullata nuk është strukturuar në mënyrë të tillë që intervali i mostrimit të korrespondojë me një karakteristikë specifike të popullatës.
- **Zgjedhja në mënyrë të çrregullt** mund të jenë një alternativë ndaj teknikës së zgjedhjes së rastësishme por vetëm në rastet kur auditorët janë të kënaqur se mostra e përfaqëson të gjithë popullatën.
- **Zgjedhja një pas një ose zgjedhja në bllok.** Mostrimi një pas një mund të përdoret për të kontrolluar faktin nëse elementë të caktuar kanë karakteristika të veçanta. Për shembull një auditor mund të përdorë si mostër 60 çeqe që vijnë njëri pas tjetrit për të kontrolluar faktin nëse çeqet janë nënshkruar apo jo nga nënshkruer të autorizuar, në vend që të nxjerrë 60 çeqe të vetëm të shpërndarë gjatë gjithë vitit.

- **Mostrimi sipas njësisë monetare (MNjM).** Kjo është një metodë zgjedhjeje e cila bën të sigurt se çdo euro e cila është pjesë e një popullate ka një shans të barabartë për t'u zgjedhur dhe testuar.

2.4.Performmi i testeve të auditimit

Auditorët zakonisht kryejnë dy lloje testimesh:

1. Testet e kontrollit dhe
2. Procedurat substanciale.

2.4.1 Testet e Kontrollit (TOC)

Testet e kontrollit (TOC) janë të dizajnuara për të vlerësuar efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në parandalimin ose në zbulimin dhe korrigjimin e gabimeve para se ata të rezultojnë në gabime materiale në pasqyrat financiare.

Këto testime përfshijnë:

- Walkthrough - pra procedura nga fillimi e deri në fund të një apo më shumë transaksionesh
- Përzgjedhja e mostrave të kontrollit në një kohë të caktuar, apo përgjatë kohës, pra percjellja si dhe ripërformimi i tyre, për të marrë dëshmi se ata veprojnë në mënyrë efektive.

2.4.2 Procedurat substanciale

Procedurat substanciale janë të dizajnuara për të zbuluar anomalitë materiale në nivel pohimi.

Këto procedura konsistojnë në përformimin e këtyre testeve:

- Testin e detajeve (Test of details) - që përfshinë inspektimin, vëzhgimin, pranimin e konfirmimeve nga palët e treta, rikalkulimet, etj.
- Procedurat substanciale analitike- që mund të shkojnë nga krahasime të thjeshta e deri të analizat me komplekse e duke përdorur teknika të avancuara statistikore. Për shembull analizat e trendeve financiare me kalimin e kohës, duke krahasuar raportet financiare me pritjet e përcaktuara dhe duke krahasuar informacionet financiare dhe jo financiare (p.sh. shpenzimet e pagave apo numrin e punëtorëve).

Procedurat substanciale pra përfshijnë përfshirjen e testeve të kontrollit si dhe procedurat substanciale analitike. Zakonisht testohen këto cikle auditimi:

Te Hyrat,

Stoku,

Pasuritë Fikse,

Shpenzimet Operative,

Të arkëtueshmet,

Te pagueshmet,

Parapagimet,

Shpenzimet Akruale,

Borxhet,

Investimet,

Paraja e Gatshme,

Ekuiteti dhe

Tatimet

Të hyrat

Çështja më e rëndësishme është se si kompanitë i gjenerojnë të hyrat?

Zakonisht kompanitë gjenerojnë të hyra nga këto veprimtari:

- Shitja me shumicë dhe pakicë
- Kompanitë komerciale të ndërtimit
- Prodhuesit e pajisjeve mjekësore
- Nga poliset e sigurimeve
- Nga interesi (bankat)
- Varësisht nga lloji i veprimtarisë që ka ajo kompani që auditohet

Çfarë i bën të hyrat si fushën më riskun më të lartë në auditim?

Janë disa faktorë që e bëjnë këtë fushë si me më riskun më të lartë:

- Kontabiliteti mund të jëtë i ndërlikuar
- Zakonisht është numri më i madh në pasqyrat financiare
- Vëllimi i madh i transaksioneve
- Është zona që përdoret më së shpeshti për mbulime në pasqyra financiare (ndodhin më së shpeshti mashtrime)

Risqet specifike në fushën e të hyrave:

- Nuk përdoren politikat përkatëse për njohjen e të hyrave
- Shitjet përfshinë transaksione mashtruese
- Të ardhurat nuk janë regjistruar në periudhën e saktë
- Të arkëtueshmet e regjistruara nuk janë valide
- Lejimet për llogaritë e dyshimta nuk janë adekuate
- Aktivitetet me palët e ndërlidhura nuk janë paraqitur në pasqyra apo nuk janë identifikuar fare

Për tu përgjigjur këtyre risqeve, duhet ndërmarrë këto veprime:

- Duhet kuptuar rrjedhen e të hyrave
- Duhet kuptuar politikat për njohjen e të ardhurave
- Duhet te kryhen procedura analitike
- Duhet te kryhen cut-off testimet

Stoku

Rrjedha tipike e procesit të blerjes është kjo:

- Marrëveshja me furnitorin, e që zakonisht bëhet pas përcaktimit të nevojave për shërbime apo për mallra
- Pranimi i të mirave apo shërbimeve
- Pranimi i mallrave në depo
- Regjistrimi i transaksioneve pasi që fatura është pranuar
- Pagesa e faturës, dhe pastaj barazimi i kontove

E si paraqitet cikli i Stokut në pasqyra ?

-Cikli i stokut paraqitet në këtë formë ne pasqyra financiare:

- Në bilancin e gjendjes: * Stoku
- *Llogaritë e pagueshme
- Në pasqyrën e të ardhurave: *Si kosto e mallit të shitur - KMSH
- Në pasqyrën e rrjedhës së parasë: *Ndryshimi i stokut
*Ndryshimi në llogaritë e pagueshme

Stoku është zakonisht fusha më e rëndësishme në auditim për këto arsye:

- kontabiliteti mund të jetë kompleks (rrjedha kostos, vlerësimi)
- zakonisht është numri më i madh në pasqyra financiare
- zakonisht ka një numër të madh të transaksioneve

- varësisht nga natyra e stokut mund të ndodhin mospërputhje
- përdoret shumë shpesh për mashtrime
- ka një ndikim të madh në kushtet e kredive.

Për te bindur veten një auditor që gjendja e stokut të paraqitur në pasqyra është reale duhet plotësuar këto pohime:

- **Ekzistenca**
- **Vlerësimi bruto**
- **Vlerësimi neto**
- **Prezentimi dhe shpalosjet**

Ekzistenca-Procedura që duhet ndërmarrë për të vërtetuar është mbikqyrja (observimi) e numërimit të stokut, që bëhet në fund vitit. Pra në çdo fundvit kompanitë bëjnë regjistrimin e stokut që ka mbetur në depot e tyre. Auditorët për të bindur veten se realisht stoku që është paraqitur në pasqyra ekziston, atëherë kontaktojnë me kompanitë - klient të tyre për informimin e datave të përfundimit të numërimit të stokut dhe regjistrimit në listën reale të stokut. Zakonisht përcjellja e numërimit të stokut nuk bëhet për tërë stokun, mirëpo auditorët bëjnë përzgjedhjen e mostrave për mbikqyrje përgjatë numërimit, dhe jo vetëm që vërtetojnë sasinë e stokut në depo, mirëpo edhe përcjellin procesin e numërimit në qoftëse po shkon ashtu siç duhet, po ashtu çështje me rëndësi është që mallrat që janë të dëmtuara apo pa afat të mos jenë të paraqitura në listën e stokut, pra nëse është bërë provizionimi i mallrave apo edhe fshirja tyre nga lista.



Figura 4. Numërimi i Stokut

Vlerësimi bruto-Procedurat që zakonisht përdoren për të vlerësuar gjendjen **bruto** të mallrave që gjenden si stok është – Testi i çmimeve, Metoda e kostove.

- Tek **testimi i çmimit** të shitjes me rëndësi është që së pari stoku a po mbahet me metoden e kostos mesatare apo me metodën FIFO, e pastaj me rëndësi është që stoku pas shitjes të kontrollohet çmimi i shtijes, pra zakonisht bëhet rikalkulimi i çmimit, si dhe shikohet në çoftëse ka pas gabime si dhe a ka diferenca në mes të kalkulimeve.
- Ndërsa tek **testi i kostove** të mallrave në depo me rëndësi është të dijmë në çoftëse mallrave kur janë blerë i janë veshur të gjitha kostot e mallit deri në mbërritje në depo, apo në çoftëse është prodhim i kompanisë atëherë a është bërë kalkulimi i kostove që nga kalimi nga lënda e parë në gjysmëprodukte e deri tek produktet e gatshme.

Vlerësimi neto-Procedurat që përdoren për të bërë vlerësimin **neto** janë:

-Metoda e vjetërsisë së stokut,

- Kostoja më e ulët apo kostoja e tregut

- Pra procedurë me rëndësi të shohim vjetërsinë e stokut, pra sa kohë ka kaluar prej mbërritjes së stokut në depo, si dhe sa zakonisht qëndron stoku në depo. Është i

rëndësisë së lartë qarkullimi i stoqeve, pasiqë në bazë të saj mund të vërehet se çfarë performance ka kompania për shitjen e mallrave.

- Poashtu me rëndësi është të dijmë nëse kompania po përdorë koston më të ulët për përcaktimin e çmimit apo është duke u bazuar në çmimin aktual të tregut.

Prezantimi dhe shpalosjet -Pra pasiqë auditorët plotësojnë kërkesat e tyre të shprehura përmes testimeve, të dhënat e mbledhura i paraqesin në pasqyra si dhe e bëjnë shpalosjen e tyre.

Pasuritë fikse

Risqet që zakonisht konsiderohen në auditim për këtë fushë janë tri :

- Lista e pasurive fikse nuk është e plotë
- Aktiviteti i pasurive fikse nuk është valid
- Transferet e pasurive nuk janë regjistruar

Formula kryesore e aseteve fikse është :

Balanca në fillim të vitit

+ Blerjet e aseteve të reja

- Shitja e aseteve apo shlyerja nga librat

=Gjendja në fund të vitit

Balanca në fillim të vitit mund të testohet duke u bazuar në letrat e punës të vitit paraprak, ndërsa nëse kompania e cila po auditohet është për herën e parë duke u audituar nga një kompani e auditimit, atëherë është me rëndësi që auditori të bind veten edhe për balancën që po paraqitet në pasqyra, e kjo duke u bazuar nga dokumentet mbështetëse të ofruara nga departamenti i financave i kompanisë përkatëse.

Blerja e asetëve të reja mund të testohet duke i kërkuar dokumentet përkatëse për blerjen e asetit si faturën e blerjes si dhe transferet bankare të pagesës.

Shitjen e asetëve mund ta testojmë duke i kërkuar klientit faturën e shitjes si dhe raportin bankar për pranimin e mjeteve.

Ndërsa si pikë me rëndësi për tu audituar është edhe zhvlerësimi për vit, e formula bazë e zhvlerësimit që përdoret nga auditorët është kjo:

Balanca në fillim të vitit

+ Shpenzimet e zhvlerësimit

- Zhvlerësimi i akumuluar në asetet e shitura

= **Gjendja në fund**

Risqet që janë të lidhura me zhvlerësimin:

-A është metoda për llogaritjen e amortizimit e arsyeshme dhe e njëjtë nga viti në vit?

-A është jetëgjatësia e pasurisë konsistente, dhe a është zhvlerësuar në mënyrën e duhur?

-A janë lejimet në zhvlerësime të përshtatshme?

shpenzimeve nga periudha në periudhën tjetër (nga muaji në muaj), auditori mundet të pyes departamentin e financave se pse ka pasur ngritje të shpenzimeve dhe në bazë të përgjigjeve të ndryshme të cilat i merr nga klienti i qet në test edhe ndonjera nga ato përgjigje mund të mbetet edhe si (findings) gjetje nëse nuk është diçka në përputhje me politikat e kompanisë apo të pronarëve. Dhe në fund patjetër jepet edhe një përfundim si dhe sqarimet përkatëse për rezultatet e testimit. Ref. F8 ACCA (*Audit and Assurance*)

Të arkëtueshmet

Tek kjo fushë e testimit me rëndësi është që lista e blerësve të jetë reale së pari, pastaj të jetë përfshirë edhe struktura e vjetërsisë së llogarive të arkëtueshme, e poashtu provizionimi është një çështje shumë e delikate pasi që në shumicën e rasteve provizionimi i llogarive të arkëtueshme nuk bëhet, pra nuk paraqiten në vlerën e tyre neto. E një procedurë e domosdoshme tek testimi i kësaj kategorie është edhe dërgimi i konfirmimeve tek palët e treta, si kërkesa që konfirmimi të ju kthehet direkt auditorëve në lidhje me borxhin që jau kanë kompanisë e cila auditohet.

“Nëse vonohen apo nuk kthehen konfirmimet në lidhje me llogaritë e arkëtueshme atëherë është një test në auditim që zhvillohet me emrin “alternativa e të arkëtueshmeve” – (Alternative of receivables), ku për ata blerës merren faturat e shitjes të cilat e përbejnë atë borxh dhe në këtë mënyrë në e shohim se a egziston ai borxh në të vertetë.” (2013) *The role and responsibilities of external audit*.

Të pagueshmet

Ngjajshëm sikur tek seksioni i llogarive të arkëtueshme edhe këtu me rëndësi është që lista e ofruar nga kompania e cila po auditohet të jetë reale, poashtu konfirmimet që janë dërguar tek palët e treta të kthehen prapa tek auditori si dhe të na konfirmojnë gjendjen e paraqitur në listën e ofruar. Ref. F8 ACCA (*Audit and Assurance*). Poashtu edhe të të pagueshmet është testi i procedurave alternative sikurse të të arkëtueshmet.

Shpenzimet akruale

Në këtë seksion e rëndësishme është që të shikohet në qoftëse shpenzimet akruale janë paraqitur në mënyren e duhur, pra zakonisht rikalkulohen duke u bazuar në datën e saktë, datë kjo e përcaktuar sipas marrëveshjeve përkatëse, dhe pastaj krahasohet me regjistrimin e kompanisë që po auditohet. (2013) *The role and responsibilities of external audit.*

Borxhet

Janë disa instrumente të borxhit: Linjat e kreditit, Letërkrediti, Kartelat e kreditit, qiraja kapitale, bonat e sigurimeve, faktoringjet, mbitërheqjet, etj..

Zakonisht kompanitë huazojnë nga: bankat, institucionet financiare, nga palët e ndërlidhura, shokët dhe famljarët, kompanite private, investitorët privat, etj.

Risqet që i kanosen këtij seksioni sipas auditorëve janë:

- Plani i borxheve nuk është përfunduar,
- Detyrimet e borxhit nuk reflektohen si duhet,
- Interesi i pagueshëm nuk është adekuat,
- Aktiviteti me palët e ndërlidhura nuk është identifikuar si dhe nuk është trajtuar ashtu siç duhet,
- Kushtet tjera të përcaktuara sipas kontratave nuk zbatohen

Procedurat që duhet ndjekur që tu përgjigjemi këtyre risqeve:

- Duhet te vërtetojmë nese i gjithë borxhi është regjistruar dhe bartet në shumën e duhur,
- Borxhi është paraqitur në kontabilitet sipas GAAP
- Detyrimet ndaj borxhit te marrë janë klasifikuar si duhet në bilanc,
- Shpenzimet e interest janë regjistruar si duhet,
- Shpalosjet janë të përshtatshme si dhe të kuptueshme.

Një faktorë më rëndësi është që të dërgohen konfirmime te palët e treta, në menyrë që te kemi siguri të plotë në lidhje me të gjitha kërkesat tona të cilat duhet permbushur. Ato që zakonisht

kërkohet që të konfirmohen nga palët e treta janë: principali i mbetur, interesi i mbetur, data se kur duhet paguhet interesi, norma e interesit, maturimi si dhe termet e ripagimit, kolaterali, si dhe detaje tjera të cilat i konsiderojmë të rëndësishme duke u bazur në institucionin nga i cili është huazuar.

Paraja e gatshme

Kompanitë gjenerojnë para nga: Shitja e mallrave, Shitja e shërbimeve, apo nga investimet.

Risqet që zakonisht i përkasin ciklit të parave të gatshme janë :

- Balanca e parave të gatshme e paraqitur në pasqyra në realitet nuk ekziston,
- Nuk janë regjistruar aktivitetet e kryera me para të gatshme
- Aktivitetet e kryera me para të gatshme nuk janë regjistruar në periudhën përkatëse,
- Mospërputhjet e parave të gatshme.

Testimet që zakonisht performohen për të verifikuar që gjendja e paraqitur në pasqyra është reale janë: Krahasimi i gjendjeve bankare për llogaritë bankare përkatëse dhe i librave të arkës me pasqyrat financiare. Pastaj bëhet poashtu edhe përgaditja e konfirmimeve bankare, e të cilat zakonisht i dërgohen bankave me kërkesë që konfirmimi të ju kthehet prapa direkt auditorëve në mënyrë që të vërtetojmë se ato balanca të paraqitura në pasqyra egzistojnë realisht edhe në bankë.” Dërgimi i konfirmimeve zakonisht bëhet para se të filloj puna në teren, për arsye që të jenë të kordinuar me kohën e përcaktuar për përfundimin e punëve.Zakonisht ndodh që konfirmimi nga palët e treta të vonohet më shumë se sa planifikohet.”(2013) *The role and responsibilities of external audit*.

Pasiqë pranohen dokumentet e nevojshme, diskutohen rezultatet e krahasimeve, si dhe paraqitet shpalosja e këtij zëri në raportin e auditorit.

Example of a Completed Standard Bank Confirmation Form

C11
DLJ
2/14/03

Bank Confirmation

Areas to be completed by client are marked §, while those to be completed by the financial institution are marked †

<p>FINANCIAL INSTITUTION § (Name, branch and full mailing address)</p> <p>CIBC P.O. Box 1947 Calgary, Alberta T2T 3Q1</p> <p>CONFIRMATION DATE § December 31, 2002 (All information to be provided as of this date) (See Bank Confirmation Completion Instructions)</p>	<p>CLIENT (Legal name) § EarthWear Clothiers</p> <p>The financial institution is authorized to provide the details requested herein to the below noted firm of accounts</p> <p>Client's authorized signature § <i>Jelly Jones</i> Please supply copy of the most recent credit facility agreement (initial if required) §</p>
---	--

LOANS AND OTHER DIRECT AND CONTINGENT LIABILITIES (If balances are nil, please state)						
NATURE OF LIABILITY/ CONTINGENT LIABILITY †	INTEREST (Note rate per contract)		DATE PAID TO †	DUE DATE †	DATE OF CREDIT FACILITY AGREEMENT †	DATE OF CREDIT FACILITY AGREEMENT †
	RATE †	RATE †				
ADDITIONAL CREDIT FACILITY AGREEMENT(S) Note the date(s) of any credit facility agreement(s) not drawn upon and not referenced above. †						

DEPOSITS/OVERDRAFTS					
TYPE OF ACCOUNT §	ACCOUNT NUMBER §	INTEREST RATE §	ISSUE DATE (If applicable) §	MATURITY DATE (If applicable) §	AMOUNT AND CURRENCY (In brackets if overdraft) §
General Account	04-78925	None			\$ 1,854,890.00 to C10
Payroll Account	01-04354	None			\$ 5,000.00 to C20

EXCEPTIONS AND COMMENTS (See Bank Confirmation Completion Instructions) †

STATEMENT OF PROCEDURES PERFORMED BY FINANCIAL INSTITUTION †
The above information was completed in accordance with the Bank Confirmation Completion Instructions.

Authorized signature of financial institution *J.S. Hammer* BRANCH CONTACT Name and telephone number

Please mail this form directly to our chartered accountant in the enclosed addressed envelope.

Name: Wilks & Adams
Address: P.O. Box 4080, Calgary, Alberta, T1T 2R2
Telephone:
Fax:

Developed by the Canadian Bankers Association and the Canadian Institute of Chartered Accountants

Figura 6. Model i nje konfirmimi bankar

Tatimet

E kur është fjala për testimin e tatimeve, mënyra se si testohen është duke i kërkuara deklaratat e tatimeve përkatëse, e kto duke i krahasuar me kalkulimet tona, gjithmonë duke i bazuar nga të dhënat e pranuar nga kompania e cila po auditohet. Pastaj jepet edhe përfundimi mbi punën e performuar, si dhe nëse kompania ka nevojë për rekomandime apo jo.

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Materiali i mbledhur për këtë temë ka për fokus të përgjigjet pyetjes “Cka është Auditimi, dhe a është me të vërtete i rëndësishem për zhvillimin e bizneseve?”. Shumica e literaturës është marr nga botime të ndryshme në gjuhën angleze. Pyetja themelore hulumtuese që është adresuar në këtë punim adreson identifikimin e procedurave audituese të performuara nga auditorët ligjor të jashtëm, dhënien e opinionit të kualifikuar dhe lëshimin e raporteve audituese. Ky punim adreson rëndësinë e auditimit të jashtëm për pronaret e kompanisë, bankat nga të cilat mund të kërkojnë kredi, si dhe për interesim të personave jashtë kompanisë për investime të ndryshme.

Qëllimi i këtij punimi është që të tregoj të mirën që rrjedh nga auditimi, pra, sigurinë e arsyeshme që pasqyrat financiare dhe shpalosjet nuk kanë gabimet materiale. Përdoruesit përkatës përfitojnë nga auditimi i kompanive dhe organizatave, sepse vërtetimet e auditorëve u japin kredibilitet informacioneve të shpërndara nga korporatat dhe reduktojnë asimetritë informative që mund të ekzistojnë ndërmjet përdoruesve dhe emetuesve të pasqyrave financiare. Tregohet rëndësia e auditimit të jashtëm për drejtorët, menaxhmentin, aksionerët, blerësit e ardhshëm. Nëse një kompani nuk auditohet nga auditorë të jashtëm atëherë ajo kompani është në rrezik të plotë për krijim të raporteve financiare të besueshme. Prandaj, një sistem auditimi është vendimtar në parandalimin e në regjistrimet dhe raportet e një kompanie.

Auditimit i jashtëm dhe rëndësia e tij kanë qenë fokus kryesor i këtij studimi. Vetëm me performimin e procedurave audituese nga auditorët e jashtëm dhe marrjen me seriozitet të rekomandimeve dhe zbatimeve të tyre, bizneset do të kenë pozitë më të favorshme financiare.

4. METODOLOGJIA

Për të realizuar këtë punim është përdorur kjo metodologji studimi:

- Secondary research (kërkim dytësor)- I cili është përdorur për të studiuar dhe kuptuar procedurat dhe rëndësinë e auditimit të jashtëm. Për këtë janë përdorur artikuj të shumtë studimor, revista, botime etj.
- Primary research (kërkim primar)- informacione të mledhura nga vëzhgimi dhe kryerja e procedurave audituese në kompani të ndryshme.

5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

Gjatë hulumtimit, është parë se ka shumë literaturë që kanë fokus kryesor auditimit e jashtëm si ceshtje mjaftë me rëndësi për biznese në Kosovë. Bazuar në këto literatura, auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi të mjaftueshme për vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorëve, duke përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të njësisë ekonomike në mënyrë që të dizajnohen procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Qëllimi i këtij punimi është që të bëhet përshkrimi i të gjitha fazave të auditimit, si dhe definimi i rëndësisë që ka auditimi i jashtëm në mbarëvajtjen e të gjitha organizatave pa marrë parasysh llojin e organizatës, respektimin e ligjeve, rregulloreve e poashtu edhe të standardeve ndërkombëtare për përpilim të pasqyrave financiare si dhe standardeve ndërkombëtare për raportim financiar.

Rast hulumtimi kam marr raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të publikuar në lidhje me auditimin e komunës së Pejës. “RAPORTI I AUDITIMIT PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016”.Raporti fillon me theksimin e përgjegjesive të Zyrës Kombëtare të Auditimit në lidhje me auditimin dhe procedurat audituese të cilat janë përformuar në komunën e Pejës. Më pastaj janë përmendur anëtarët e ekipes të cilet kanë kryer auditimin dhe kanë lëshuar raportin dhe opinionin. Më pastaj është paraqitur ‘‘Tabela e Përmbajtjes’’ e cila përbëhet prej:

Përmbledhje përgjithshme

Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Qeverisja

Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Shtojca IV: Letërkonfirmimi

Tek Përmbledhja e përgjithshme është dhënë Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm, i cili nënkupton gjendjen e paraqitjes së pasqyrave financiare, thekson nënvlerësimin apo mbivlerësimin e pasurive të komunës, llogaritë e arkëtueshme etj, Për komunën e Pejës Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm, është dhënë në këtë mënyre:

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare vjetore prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale

Theksimi i çështjes

Si theksim i çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuritë e komunës ishin nënvlerësuar për 5,254,200€, si dhe llogaritë e arkëtueshme për tatim në pronë ishin mbivlerësuar për 545,629€, ndërsa ato nga ushtrimi i veprimtarisë afariste i subjekteve ekonomike ishin nënvlerësuar për 209,520€.

Në raportet audituese gjithmone jepen konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse. Një konkluzion mund të ketë këtë formë:

“Në planifikimin dhe realizimin e buxhetit, të hyrave, dhe shpenzimeve ishin identifikuar mangësi në konrolle” (2013) The role and responsibilities of external audit.

Auditori i jashtëm ka vërejtur mangësi të theksuar në planifikim dhe realizimin e buxhetit, të hyrave dhe shpenzimeve. Këto mangësi arsyetohen me të gjeturat dhe faktet që auditorët posedojnë në formën fizike (fatura, bilance etj). Në lidhje me këtë të gjetur është dhënë rekomandimi për përmisimin dhe mos përsëritjen e tij në të ardhmen. Rekomandimet jepen në këtë mënyre:

“Kryetari duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të fushave brengosëse të theksuara në këtë Raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato” (2013) The role and responsibilities of external audit.

Auditori ka vlerësuar zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak, dhe ka ardh në përfundim se vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë adresuar, sepse Komuna e Pejës nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP.Rrezik për të cilat janë dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit në sistemet financiare kyçe, si dhe fushave të tjera të veprimtarisë kanë rezultuar në mos zbatimin e plotë të rekomandimeve paraprake. Së këndejmi, qeverisja komunale mund të mos i përmbushë në mënyrë cilësore objektivat e sajë organizative të cilat do të ndikonin edhe në cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Ndërsa rekomandim për këtë të gjetur është kryetari duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioritetëve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka ngecje, të propozohen masat adekuate

Në lidhje me raportim menaxherial dhe llogaridhënie janë gjetur dobësi në kontrollet menaxheriale e cila listohet tek të gjeturat me prioritet të lartë. Rishikimi i auditoëve tek kontrollet menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Në lidhje me këtë të gjetur është dhënë rekomandimi i aditorëve ku është cekur se kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë. Ecuritë buxhetore duhet të mbikëqyren vazhdimisht për të shmangur suficitet e fundvitit si dhe për të rritur nivelin e arkëtimeve.

Të gjetura ka pasur edhe tek Sistemi I kontrollit të brendshëm, Menaxhimi I Buxhetit, Të hyrat, Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale, Subvencionet dhe transferet, Investimet kapitale, Pasurite, Te arkëtueshmet, Obligimet e papaguara.

Auditori ka cekur definimin e të gjeturave:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Raportit auditues i është bashkangjitur tabela në lidhje me progresin e rekomandimeve të viit paraprak, e cila është plotësuar nga stafi I komunës së Pejës. Ata I janë përgjigjur dhe aryetuar cdo rekomandimi në njërin nga tri opsionet:

Të zbatuara

Në proces të zbatimit

Të pa zbatuara

Në fund të raportit, është bashkangjitur Letërkonfirmimie cila është nënshkruar nga kryertari I komunës së Pejës I cili konfirmon se ka pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, pajtohet me të gjeturat dhe rekomandimet, dhe se brenda 30 ditëve do të dorëzoj një plan veprimi për implementimin e rekomandimeve të dhëna.

Ref. F8 ACCA(*Audit and Assurance*)

6. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Në punimin e temës “Auditimi i Jashtëm dhe ndikimi i tij ne biznese” u synua që të theksohet fakti se sa e rëndësishme është për një kompani kryerja e procedurave të auditimit të jashtëm dhe njëkohësisht ndikimi i këtyre procedurave në biznese.

Kur kontraktohet nga kontrollorët e biznesit, procesi i auditimit të jashtëm mund të ndodh për dy arsye. Së pari, kompania është shumë më efektive kur përformohen procedurat e auditimit të jashtëm. Kjo mund të ndodhë për shumë arsye: punonjësit e kompanisë janë të zënë tashmë në detyra të tjera, auditorët e jashtëm janë më të trajnuar këtë qëllim, mashtrimet e brendshme mund të rezultojnë edhe në një auditim të brendshëm jo real dhe jo të vlefshëm. Në çdo rast, kompania do të përdorë një kompani të auditimit të jashtëm për të gjetur përgjigjen për disa pyetje rreth gjendjes ekzistuese të kompanisë së tyre. Nje kompanie i nevojitet përformimi i procedurave audituese të auditimit të jashtëm nga kompanitë profesionale në rast se mungojnë fonde apo nuk shpjegohen bindshëm dhe ngjallin dyshime, për të dhënë një opinion të dytë, ose thjesht për të kryer auditimin i cili përformohet në periudha të caktuara kohore.

Së dyti, një raport i auditimit të jashtëm mund të ndodhë kur një njësi qeveritare ka dyshime për një pjesë të pasqyrave financiare të një kompanie. Në këtë rast, një auditim i jashtëm nuk do të jetë vullnetar zakonisht një gjykatë e mandatojnë atë. Ka shumë arsye pse një auditim i jashtëm do të ndodhë në këto situata: ka pyetje pa përgjigje të bindshme për pasqyrat financiare të një kompanie, auditimi i jashtëm mund të zbulojë mashtrim të brendshëm,

kompania mund të mos krijojë deklarata në pajtim me ligjin. Një gjykatë autorizon auditimin sepse dyshon se fondet mund të janë shpenzuar për aktivitete të paligjshme. Tarifat e auditimit të jashtëm zakonisht paguhen nga biznesi që auditohet.

Me anë të studimit përgjegjësia e plotë mbi funksionimin e bizneseve bie mbi menaxhmentin dhe auditorin.

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme të përcaktuara nga menaxhmenti si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimet apo gabimet.

Përgjegjësia e auditorëve të jashtëm është të shprehin një opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi të mjaftueshme për vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorëve, duke përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të njësisë ekonomike në mënyrë që të dizajnohen procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve

kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Kompania e auditimit pas perfundimit mund nëse gjithçka ka qenë në rregull “**Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.**”(*The role and responsibilities of external audit, 2013*)

Opinion

Opinion i nje projekti auditues shprehet në këtë formë:
Sipas auditimit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të “XY” me 31 dhjetor 2015, performancës së saj financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. (SNRF).

Çështje tjera

Në rast se kompania në fjalë është audituar nga një kompani tjetër audituese atëherë auditorët e vitit aktual nuk marrin fare përgjegjësi dhe pas shprehjes së opinionit shtojnë:

Pasqyrat financiare të “XY” për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2014 janë audituar nga një auditor tjetër i cili shprehu një opinion të pakualifikuar për ato pasqyra me 28 shkurt 2015.

Rekomandimet

Pra, rekomandohet që kompania e cila auditohet t’i shfrytëzoj auditorët për të diskutuar mbi mënyrat për përmirësimin sistemeve dhe procedurave të kontabilitetit të saj. Pas punës se

auditorëve behet “ Management letter” në të cilën janë të përmbledhura të gjeturat nga auditimi për kohën e caktuar të auditimit, ku nxirren në pah dobësitë si dhe bëhen rekomandime për përmirësime në të ardhmen.

Pas dhënies së opinionit, kualifikimeve (në qoftëse ka), si dhe rekomandimeve, paraqitet gjendja e pasqyrave financiare, e poshtu duke u shpalosur secili zë i pasqyrave në shënimet përkatëse. Shënimet paraqiten zakonisht në faqet e fundit të raportit, ndërsa janë të specifikuar me numra përkatës, në mënyrë që të jenë të ndërlidhura me pasqyrat financiare.

7. REFERENCAT

- Brenda Porter, David Hatherly, and Jon Simon (2003) *Principles of External Auditing*
- ACCA F8 (2014) *Audit and Assurance*
- ZAP Auditimi: *Strategjia për zhvillim të përbashkët*
- Department of Health and Human Services, (1994) Office of Inspector General, Office of Audit Services - *The Audit Progress*
- Irena Islami; Amantja Patozi, *Auditimi Publik*, Revistë katërmujore
- Jack Ori (2016) Importance of an External Audit. Retrived from <http://smallbusiness.chron.com/importance-external-audit-17630.html>
- Marquis Codjia (2017) *The purpouse of an external audit*. Retrieved from: <https://bizfluent.com/about-6614835-purpose-external-audit.html>
- Lisa Clamping (2013) *The role and responsibilities of external audit*. Retrieved from: <http://rds.eppingforestdc.gov.uk/documents/s9676/External%20Audit%20Presentation.pdf>
- Ken Williamson (2013) *Assessing the effectiveness of the external audit process*. Retrieved from: [http://www.ey.com/Publication/vwLUAssets/Assessing_the_effectiveness_of_the_external_audit_process_November_2013/\\$FILE/EY_Assessing_the_effectiveness_of_the_external_audit_process_November_2013.pdf](http://www.ey.com/Publication/vwLUAssets/Assessing_the_effectiveness_of_the_external_audit_process_November_2013/$FILE/EY_Assessing_the_effectiveness_of_the_external_audit_process_November_2013.pdf)

- ZKA - Raporti i auditimit për raportin financiar vjetor të komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016. Retrieved from: <https://kk.rks-gov.net/peje/getattachment/Temat/Raportet-2014---2015/Raporti-Auditimit--KPE-2016.pdf.aspx>